

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Pune Publike**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“Ndertimi i rrjetit KUZ , qyteti Prrenjas ”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

45232400-6 Punime ndërtimi për kanalizime

**VLERA E FONDIT LIMIT: 248 351 559 (dyqind e dyzet e tete milion e treqind e pesedhjet e nje mije e peseqind e pesedhjet e nente )leke pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Për mbledhës të Vetëdeklarimit , sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimine Ofertës ,sipas Shtojcës 3;

**2. Ofertuesiduhettëparaqesë:**

**2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

*Sipas përcaktimeve në Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes /Kualifikimit, sipas Shtojcës 7*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në kërkesat e pikës 1, Shtojca7.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- 2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2021,2022,2023) të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivit.
- 2.2.2 Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021,2022,2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50% e vlerës së parashikuar të kontratës që po prokurohet.Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.
- 2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2023. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2023, sipas të dhënave të QKB-së

**Shënim:** Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese kriteri 2.2.3 do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77, pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik ku përcaktohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në :b) **gjendjen ekonomike dhe**

**financiare ;... 3)**Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë **një xhiro vjetore minimale të caktuar**. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin **informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit**. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...”

Në **nenin 43**“Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021“Përmirimitin e rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3(tre) vitet e fundit financiare.**”

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet:...**b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;**

Nëse vlerësohet, Autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vite te fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Gjithashtu, për caktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i’u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht:

**Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998** “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili percakton”Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar nëudhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancinkontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financavenë zbatim të këtij ligji.

**Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5** datë 30.01.2006 ”Për tatimin mbi të ardhurat ” ,i ndryshuar pika 3.12etij, dhe kërkesave të **Ligjit Nr.25 datë 10.05.2018** ”Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare ” neni 9 i tij ku parashikohet: ”Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon nëdatën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përjashtimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit , miratohen nga ministri përgjegjës për financat”.

**Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009** “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” gjykojmë që të kërkojmë xhiron vjetore dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2021,2022,2023) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë ) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Gjithashtu komisioni kërkoi edhe pagesat e taksave vendore bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (të ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga cdo njësi e qeverisjes vendore si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këtotë fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre , atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

**Komisioni përcaktoi kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qënë se këto kritere janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre përpërbushjen me sukses të kontratës.**

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

2.3.1 Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin:

- a) dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, (te natyrës se ngjashme sipas preventivit).
- b) dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
  - Kontratë Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Aktin e kolaudimit;
  
- Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :
  - Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
  - Kontrate Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Fatura tatimore perkatese.
  -

### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” kupërcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike , si dhe **përvojën e nevojshme** për të zbatuar kontratën sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore , në veçanti , mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 te VKM Nr. 285 datë19.05.2021“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: “ Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerëjo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet .**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipër përmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme , kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik , për përmbushjen me sukses të kontratës , ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen esuksesshme të punëve. Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti

kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës , ku të shënohen vlera , afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë , e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor , përveç kërkesa vetë parashikuara në këtë nen , mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta , në varësi të objektit që prokurohet , të cilati vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

**Komisioni përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme , janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.**

Sipas këtij neni, Komisioni vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentacioneve ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998“Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe akte venë zbatim të tij , pasi duke qënë se kontrata për punë publike që prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin dhe situacionet përfundimtare si dhe formular vlerësimi për punët e kryera me entet publike, për të patur mundësi të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punime te mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim,në vërtetimet që lëshojnë Autoritetet Kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

**Meqenëse se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës,po r i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre,dukemundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk kanevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar),Komisioni gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.**

**2.3.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar,në përputhje me zërat e punimeve që përfshihen në preventivin e punimeve, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

<b>Kategoria NP-1 B</b>	Punime germimi ne toke	<b>Vlera 38 408 837 leke</b>
<b>Kategoria NP-4 B</b>	Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai	<b>Vlera 43 561 445 leke</b>
<b>Kategoria NP-5 B</b>	Punime nëntoksore, ura e vepra arti	<b>Vlera 22 412 915 leke</b>
<b>Kategoria NP-7 D</b>	Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje	<b>Vlera 130 730 862 leke</b>

**Kategoria NP-12 A** Punime te inxhinierise se mjedisit

**Vlera 5 000 000 leke**

**Kategoria NS- 9 A** Punime strukurore speciale

**Vlera 3 000 000 leke**

**Kategoria NS-18 A** Punime topogjeodezike

**Vlera 5 000 000 leke**

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet:“Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat përkualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burime te nevojshme njerëzore e teknike** , si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”.

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike ” pika 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” përcaktohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a)**licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve,objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore ;”

VKM Nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi ” ( lidhja 2,3 dhe 4).

Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”(të ndryshuar), dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhëniessë licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi ”, komisioni vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në liçensën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës.

Konkretisht llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre , sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

**Sipas VKM Nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar:**

**Kategoria N.P-1**“Punime gërmimi në tokë”Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale , argjilore , ranore , zhavorrishte ose shkëmbore.

Kjo kategori është kërkuar duke patur parasysh se parashikohen në preventiv punimet gërmim dhe me krah dhe makineri, mbushje, ngjeshje, sistemim të tokës etj, proceset te cilat do të kryhen me qellim shtrimin e tubacioneve të linjës kryesore dhe ate të shpërndarjes . Në preventiv janë parashikuar në total volume dhera të gërmuara, të cilat konkretisht karakterizohen nga gërmim dhe me eskavator me goma, etj. Më tej ajo mbulon të gjitha punimet që lidhen me konstruksionin e prerjeve , largimin e materialeve të papërshtatshme në hedhurina. Këto procese janë të parashikuara në preventiv dhe në specifikimet teknike të publikuara në SPE.

- **Kategoria NP- 4** “Rrugë, autostrada,mbikalime, hekurudha ...”, Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të vecanta, tunelet,devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet e realizuara me materiale të vecanta, natyrore dhe artificjale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndërë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i cdo vepre lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv sic është shtresë stabilizanti, prerje asfalti, hidroizolim me emulsion bitumi dhe punime shtresash, etj.

**Kategoria N.P-5** Punime nëtokësore. Konsiderohen. ndërtime mirëmbajtje ose ristrukturim, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntoke që janë të lidhura me ndjeshmërine e lëvizshmërisë mbi “goma” ose mbi “hekur”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtës. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntoksore, tunele.

**Kategoria N.P-7** “Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje” Konsiderohen ndërtime,mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin“e shërbimit hidrik kompleks”ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave,vajrave dhe veprave lidhëse,plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.Përfshin në mënyrë të thjeshtuar **veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujitë pijshëm, ujësjiellsat, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetinshpërndarës** deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave tëzeza,sidhetrajtimine ujërave tëpërdorura.



Kjo kategori licence i referohet së pari **objektit të kontratës** dhe së dyti punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht furnizim vendosje tubaPE 100 dhe HDPE, punime në kaptazhe, puseta kontrolli, tuba celiku, furnizim vendosje tuba dhe rakorderi ujësjellësi etj.

**Kategoria NP-12** Punime të inxhinierisë së mjedisit. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimet të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekulibrave hidrogjeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.

Kjo kategori license është vendosur duke patur parasysh se punimet duhet të kryhen me kujdes për të mos prishur strukturën e tokës, rehabilitimi i tokës do të kryhet pas punimeve të ndërtimit si edhe depozitimi i mbetjeve nga gërmimet apo prishjet në vendodhjet e percaktuara.

**Kategoria N.S- 9** Punime strukturore speciale. Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për trasmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshëm për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuar për tu ndërtuar në terrene rezistentë dhe jo të deformueshëm por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotave të çfardollos tipit, të themeleve nëntokësore me pilota ose me mure mbajtës, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntoksore me mjete speciale, përfshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratoriale nga pikpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizim dhe konsolidim të terreneve.

**Kategoria NS 18** Punime topogjeodezike. Kjo pikë licence përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin erelivimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike etj. Gjithashtu është vendosur në përputhje me punimet që do të realizohen bazuar në projektine zbatimit dhe në preventivine punimeve.

Konkretisht kjo kategori licence është e domosdoshme për piketimet e kanaleve që do të gërmohen dhe sistemeve topografike.

**Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategoritë respektive është kërkuar bazuar në zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave të kufijve të parashikuara në VKM Nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar.**

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “ Grumbulim dhe transportim i mbetjeve

inerte dhe dhera si mbetje te parrezikshme ” . Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, date 11.05.2009 “Per disa ndyshime ne legjislacionin ne fuqi per licensat,autorizimetdhe lejet ne Republiken e Shqiperise”)Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

**Argumentimi:** Duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (dheu, shkëmbi, kanale), prishje (prerje) asfalti, prishje shtresë betoni etj., dhe kryerjen e transportit të tyre në venddepozitimet e miratuara, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve,Njësia e Prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve inerte (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto liçenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë një punësim mesatar i të paktën **105 (njqind e pese)**personave, të cilët duhet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per periudhen e fundit te deklaruar.
- Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

**Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.**

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik drejtues teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te perfshire ne liçensen e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse, CV si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per periudhen per 3 (tre) muajt e fundit ,konkretisht;

- a) 1(nje) Inxhinier Ndertimi

- b) 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- c) 1 (një) Inxhinier Topograf
- d) 1 (një) Inxhinier Mjedisi

Për inxhinieret drejtues teknik si mësipërm duhet të paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme
- Diplomë;
- Librezë pune;
- CV

**Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.**

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar e kontratë pune të vlefshme, pajisur me diploma/certifikata të formimit profesional lëshuar nga autoritete përgjegjëse të akredituara/licensuara si dhe deshmi të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 1 (nje) punonjes teknik Ndertimi
- 1 (nje) punonjes teknik topograf
- 3 (tre) punonjes Hidraulik
- 1 (nje) punonjes montator
- 1 (nje) punonjes saldator
- 2 (dy) punonjes hekurkthyes
- 2 (dy) punonjes pllakashtrues
- 3 ( tre ) punonjes karpentiere
- 3 (tre) punonjes betonues
- 3 (tre) punonjes për punime në rrugë dhe asfaltim
- 2 (dy) automakinist
- 4 (kater) punonjes manovrator
- 5 (pese) punonjes shofera
- 1 (nje) punonjes buldozerist
- 

Për këta punonjes (1-10), operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;

- një dokument (diplomë profesionale/certifikate që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente.
- certifikate të sigurimit teknik lëshuar nga institucione të autorizuar nga /ish (IQT) e cila të jete e lëshuar nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ekuivalente ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Për punonjësit (11-14) manovrator/shofer/automakinist/buldozerist, ofertuesi duhet të paraqesë:  
Kontratën individuale të punës të vlefshme; leje drejtimi, certifikate e aftësi profesionale për shofer; deshmi e aftësi profesionale për manovrator/automakinist/buldozerist; Në rastin kur mjetet e kerkuara janë të marra me qera, punonjësit (Manovrator/shofer) nuk kërkohet të figurojnë në liste pagesat e shoqërisë, mund të kontrahohen me kontratë pune.

**Shënim:**Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikues ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat i lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar personel të kualifikuar/ certifikuar shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/ certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë 3 (tre) muajt e fundit të paktën;

- 1 (një) punonjës që të disponojë Çertifikatën e trajnimit si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë

18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" Ose kontratë shërbimi me subjekte private të licensuara për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.

ose

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë,
- 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", të pajisur me çertifikate të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.

**Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.**

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues minimumi 3 (tre) muajt e fundit ose duhet të paraqitet një kontratë e vlefshme për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të licensuar, sipas ligjit. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili nga operatorët ekonomikë duhet ta plotësojë këtë kusht në përputhje me numrin respektiv të punonjësve sipas kërkesave ligjore.

**Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.**

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" në të cilin parashikohet: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë **burime te nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratësore në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, **si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për mbushjen e këtyre kriterëve.”**

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “ Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/entikontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe /ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;

Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesa vetë parashikuara në këtë nen , mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurrohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej 105 punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, komisioni ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentat e tenderit , prej periudhën 18 muaj , ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar dhe punëtore për punime krahe, drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të renda etj, duke patur parasysh njëkohësisht volumin e lartë të punimeve, punime këto të cilat duhet të realizohen brenda afatit të parashikuar të objektit në grafikun e punimeve, gjithsej 18 muaj, lind nevoja për këtë fuqi të përcaktuar punëtore.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**Konkretisht:** Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar

nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

**Drejtuesi teknik është përgjegjës** për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, komisioni referuar zërave të punimeve që do të kryhen objekt kontrate ,vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara. Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës që i është bërë preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik), ku më hollësisht parashtrojmë:

- Është kërkuar **inxhinier ndërtimi**, i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit qëprokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivave të punimeve, kontrollit tëpunimeve të betonit të pranishme në preventiv si: punime germimi, prishje shtrese betoni, germime shkëmbi, germime kanalash në tokë të fortë, është e nevojshme ndjekja e punimeve edhe nga inxhinierët e ndërtimit;
- Është kërkuar **inxhinier hidroteknik** i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve voluminozehidraulike lidhur me zërat e preventivave të punimeve seksioni “Punime hidroteknike”, kontrollin e gjithë punimeve pasi ky objekt ka për qëllim ndërtimin e linjës kryesore të transmetimit të ujit nga depo ekzistuese Lis deri në depon e re, rrethim i kaptazhit,punime për linjë dërgimi nga burimi nëpër depo, furnizim vendosjen e tubacioneve dhe rakorderive tëujësjellësitpërgjatë gjithë rrjetitdhe është e nevojshme që punimet të zbatohen dhe kontrollohen në mënyrë konkrete nga ana e inxhinierit.
- Është kërkuar **inxhinier gjeodet/topograf** pasi do të kryejë azhornimin topofarik dhe piketimin e linjës Kalimit te hekurudhes dhe rruge auto me tubo celiku, dhe në bazë të këtij azhornimi do të llogariten edhe bërrylat e nevojshëm në kthesat që merr linja sipas terrenit si dhe do të ndjekë punimet e zbatimit sipas kuotave të projektit. Gjithashtu pas përfundimit të punimeve do të bejë edhe azhornimin faktit (as built);
- Është kërkuar minimuni **Inxhinier Mjedisi** referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar **NP 12A** eshte e nevojshme prezenca e Inxhinierit te Mjedisit i cili do te beje mbikqyrjen e vazhdueshme te ndikimit ne mjedisit qe ka zbatimi i punimeve objekt kontrate.

Referuar natyrës, dhe përmasave/volumit të punimeve që përmban objekti i prokurimit, me qëllim vërtetimin e aftësisë zbatuese të kontratës, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomikë duhet të disponojnë stafin mbështetës të kualifikuar për kryerjen e të gjitha punimeve objekt prokurimi dhe janë përcaktuar kërkesat minimale për punonjësit e kualifikuar që duhet të disponojnë operatorët ekonomikë ofertues për realizimin e këtij objekti.

Janë kërkuar punonjës të specializuar dhe të certifikuar me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike tëzbatimit dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën;

### **Konkretisht janë kërkuar:**

- **Hidraulikë**, të cilët sic parashtruar më lart janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e të gjithapunimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve ku punimet hidraulike zënë pjesën më tëkonsiderueshme të punimevetëkontratës dhe pasi pa këta punonjës nuk mund të kryhen apo realizohen punimet objekt prokurimi.
  - **Teknik ndërtimi**, të cilët janë të nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, duke patur parasysh punime ndërtimore që do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve.
  - Punonjes **teknik topograf, i** nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të piketimit dhe matje topografike,duke patur parasysh punime ndërtimore që do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve.
  - Punonjësit **saldatorë** janë kërkuar për kryerjen e të gjitha punimeve që kanë të bëjnë me rrjetin e ujësjellësit, montimin e tubave dhe rakorderive.Këto përcaktime janë bërë edhe në specifikimet teknike të publikuara në SPE.
  - Specialistët **karpentier** janë kërkuar për të realizuar punimet e armaturave në beton duke patur parasysh volumin e madh të punimeve (referuar preventivit).
  - Punonjësit **montatorë** janë kërkuar pasi është e rëndësishme që gjatë realizimit të proceseve të punës të asistohen nga personel për montimin e tubave që kanë diametër dhe peshë të konsiderueshme dhe rakorderive.
  - Punonjes **pllakashtrues** jane kerkuar pasi është e rëndësishme që gjatë realizimit të proceseve të punësTrotuar, me 6 cm beton, me pllaka.
  - Punonjes **Hekurkthyes**, jane kerkuar per punimet e hekurit, sipas zerave te preventivit.
  - Punonjes **betonues**,të cilët janë të nevojshëm për kryerjen e punimeve të betonimit te cilat zene nje volum te konsiderueshem pune.
  - Punonjes per **punime ne rruge dhe asfaltim** jane kerkuar pasi është e rëndësishme që gjatë realizimit të proceseve të punës se shtresave asfaltike, asfaltobeton dhe konglomerate.
  - **Shoferët** janë punonjës të cilët do të jenë përgjegjës për ecurinë e mjeteve të transportit dherave, inerteve etj,të cilat do të përdoren për punimet e këtij objekti.
  - **Automakinistet** jane punonjes te kualifikuar sipas legjislacionit ne fuqi per drejtimin e mjeteve ATP, autobetoniere, autopompa dhe autovinça, te cilet jane perlllogaritur si mjete te nevojshme per realizimin e punimeve te preventivit.
  - Punonjes **buldozerist per drejtimin e mjetit buldozer.**
- Është kërkuar 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimi si “Përgjegjës për sigurimin teknik dheshëndetinnëpunë”.



**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme mbështetet në Ligjin Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë"dheV.K.M nr.312, datë 05.05.2010" Për miratimin e rregullores Për sigurinë në kantier".Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh njëosedisapersonasipërgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë embrojtjen e shëndetit.

Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

- Eshte kerkuar qe për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

<b>Nr.</b>	<b>Emër Mbiemër i punonjësit</b>	<b>Profesioni</b>	<b>Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës</b>	<b>Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)</b>
1				
2				
etj				

Kjo kekesë behet per tu siguruar qe diplomë profesionale/certifikate që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente, janë lëshuar nga institucione te lecencuara si me siper.

- Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742 datë 06.11.2013, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes se bashkëpunimit.
- Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar minimuni 1 (një) punonjës specialist si Ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, të certifikuar nga Drejtoria e MZSH-së. Për përmbushjen e këtij kriteri Operatori ekonomikë duhet të paraqesë Certifikatat e Trajnimit/Dëshmi kualifikimi për inxhinierin përkatës.
- Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar minimuni 1 (një) punonjës që përmbush kriteret për të qenë “Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”. Për përmbushjen e këtij kriteri Operatori

**Argumentimi:** Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 692 datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë” (i ndryshuar me VKM-në nr.742, datë 06.11.2003), komisioni vlerëson se operatorët ekonomikë për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme, duhet të disponojnë si pjesë të stafit ose të nënshkruajë kontratë shërbimi me një mjek të përgjithshëm, duke qënë se është detyrim ligjor mbulimi me shërbim mjekësor të ndërmarrjes nga ana e punëdhënësit, dhe mbulimi i këtij shërbimi në aspektin shëndetësor duhet të kryhet nga mjeku i punës i licencuar, komisioni vlerëson se, kërkesa për disponimin e mjekut të ndërmarrjes ose të kontraktuar është një detyrim ligjor për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar në përputhje me ligjin, duhet vërtetojnë disponimin e tij.

**Punonjësit, specialistët, inxhinierët dhe stafi i kualifikuar të kërkuar i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 në DST, duhet që nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t’u paraqitur, të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.**

2.3.9 Operatori ekonomik duhet te disponoje:

a) Ne përputhje me kërkesat dhe dimensionet e publikuara nga Autoriteti Kontraktor ne specifikimet teknike dhe projekt preventiv, per materialet hidraulike:

- Tuba te brinjezuar HDPE SN8
- Tuba dhe rakorderi ujesjellesi PE 100PN10

**Operatori Ekonomik duhet te paraqese:**

1. Autorizim te Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributor i autorizuar prej Prodhuesitose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave lidhur jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. Ne rast te disponimit te autorizimit te prodhuesit ne gjuhe te huaj, ky dokument te paraqitet i perkthyer dhe i noterizuar ne gjuhen zyrtare shqipe.
2. Katalogun / et ose fragmente te katalogut/eve e prodhuesit / ve per listen e mesiperme te artikujve ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen. Shenim:

Fragmentet e Katalogut / ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

Të gjitha materialet e mesiperme duhet të jenë sipas Standarteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të çertifikuar me ISO 9001(ose ekuivalent) dhe / ose të pajisur me Çertifikatë konformiteti për produktet e kërkuara. Tubat HDPE duhet te jene me certifikate akreditimi nga laboratorit.

**Argumentimi:** Paraqitja e këtyre dokumenteve është vlerësuar nga komisioni pasi duke qenë se në objektin e prokurimit kemi të bëjmë me blerjen e materialeve dhe pajisjeve që dotë vendosen në punimet objekt kontrate, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duhet që këto materiale e pajisje të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si :Autorizim prodhuesi ose distributorin, katalogët ose pjesë të tyre, dëshmitë e testeve të kryera, me qëllim realizimin mesukses të kontratës.

**2.3.10** Operatori ekonomik duhet të disponojë impiant prodhimi dhe përpunimi të asfalto betonit dhe per elementet e betonit (puseta betoni, bordura betoni, pllaka trotuari) në pronësi/me qera ose të paraqesë kontratë furnizimi për mallrat objekt prokurimi, të lidhur para noterit, me afat deri në përfundimin e objektit ne fjale. Për impiantin duhet të paraqitet Leje Mjedisore tipi B (Kodi III.1.B), e vlefshme shoqeruar me aktin e pronesise perkatesisht.

**Argumentimi:** Paraqitja e këtyre dokumenteve është vlerësuar nga , pasi duke qenë se në objektin e prokurimit kemi të bëjmë me blerjen e materialeve dhe pajisjeve që do të vendosen në punimet objekt kontrate, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duhet që këto materiale e pajisje të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre,duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si:Autorizim prodhuesi ose distributorin,katalogët ose pjesë të tyre,dëshmitë e testeve të kryera,me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

2.3.11 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë të përcaktuara si më poshtë:

**Certifikatë ISO 9001: - Certifikim per menaxhimin e cilesise ose ekuivalente** (e vlefshme për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit në mënyre qe OE te siguroje një furnizim me cilesi dhe standarte europiane e cila duhet te jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Duke qenë se kjo lloj certifikate ISO-mund të ketë evoluar ndër vite do te pranohet edhe cdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO;

**Certifikatë ISO 14001: - Sistemi i Menaxherial i Mjedisit ose ekuivalente** (e vlefshme për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e

Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do te pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO.

**Certifikatë ISO 45001: - Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë ose ekuivalente**, e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarde evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do te pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO.

**Argumentimi:**Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet:“Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme** njerëzore e **teknike**,si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në nenin 44“Kërkesat e cilësisë”të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet:“Autoriteti/entikontraktor,për të vërtetuar se punët,mallrat ose shërbimet,objekt prokurimi,i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata të lëshuara** nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë,vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektine prokurimit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë,standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standarde të menaxhimit të mjedisit.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nën ligjore të sipërcituara,Autoriteti Kontraktor vlerëson se:

Autoriteti Kontraktor gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesa të standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen,jane kërkuar çertifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime.

Komisioni përcaktoi kriteret si më lart duke qënë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë Autoritetit tonë Kontraktor për

njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Konkretisht **Certifikatë ISO 9001 - 2015** “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi e cila mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës përpersonelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj.

**Certifikatë ISO 45001-2018** “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë” mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

**Certifikatë ISO 14001-2015** “Për sistemin e menaxhimit të mjedisit” është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana tjetër (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis, si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra, ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

2.3.12 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Lloji i makinerive/pajisjeve	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 15 ton	Ne pronesi ose me qira	4(kater) cope
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	Ne pronesi ose me qira	3(tre) cope
3	Kamioncine me kapacitet mbajtes deri 3 ton	Ne pronesi ose me qira	4 (kater) cope
4	Kamion me kapacitet mbajtes 5-7 ton	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
5	Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5 – 5 ton	Ne pronesi ose me qira	2 (cope) cope
6	Autobot uji	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
7	Ekskavatore me zinxhire	Ne pronesi ose me qira	3 (tre) cope

8	Miniekskavatore me zinxhire	Ne pronesi ose me qira	2 (dy) cope
9	Eskavator me goma	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
10	Bobcat me goma	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
11	Fadrome me goma	Ne pronesi ose me qira	2 (dy) cope
12	Vibrator thellesie	Ne pronesi ose me qira	2 (dy) cope
13	Betoniere kantieri	Ne pronesi ose me qira	3 (tre) cope
14	Elektrobango	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
15	Matrapik	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
16	Saldatrice	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
17	Tokmak ngjeshes	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
18	Gjenerator	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
19	Makineri për shpim horizontal për të zëvendësuar tubin ekzistues për kalimin e tubacioneve	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
20	Makineri me lazer per germim kanali nentokesor mikrotunel d=140mm.	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
21	Aparat per ngjitje tubash me elektrofuzion	Ne pronesi ose me qira	2 (dy) cope
22	Kontenier per zyra	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
23	Rrul asfalti gom gome mbi 18 (ton)	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
24	Armature sigurie per hapje kanali .Palangola	Ne pronesi ose me qira	5 (pese) cope
25	Rrul vibrues hekur hekur mbi 8 ton	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
26	Rrul gom hekur mbi 10 ton	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
27	Armatura betoni	Ne pronesi ose me qira	100 m2
28	Sharre asfalti	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
29	Asfaltoshtruese	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
30	Autobitumatrice	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
31	Autobetoniere	Ne pronesi ose me qira	2 (dy) cope

32	Autopompe betoni	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
33	Buldozer	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
34	Automjet teknologjik per pastrimin e pusetave te kolektoreve te KUZ dhe KUSH dhe pusetave te shiut e pajisur me bot me kapacitet bartes jo me pak se 4 ton, e pajisur me kove hidraulike per ngarkimin e materialeve te ngurta dhe vinc me kapacitet ngrites jo me pak se 0.3 ton.	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
35	Automjet teknologjik per inspektimin e kolektoreve me diameter (100÷2000) mm e pajisur me dy ose me shume sisteme kamerash per gjatesi inspektimi jo me pak se 200 m	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
36	Motopompe per largimin e ujrave te ndotura me prurje deri ne 4000 litra/minut, dhe presion pune jo me te vogel se 8 bar.	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
37	Fabrikë asfalti (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B	Ne pronesi / me qira/ kontrat furnizimi	1 (nje) cope
<b>PAJISJE MBROJTESE</b>			
Kokore		70 copë	
Jeleke		70 copë	
Kuti te ndihmës së shpejtë		5 cope	
Tabela sinjalistike mbrojtese		15 cope	

**Shenim: Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**

- a) Për makineri dhe mjete që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit: çertifikatë pronësie, leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, siguracionin;

- b) Ndërsa për makineri dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- c) Për makineri dhe mjete që nuk shënohen në regjistra publikë (makineritë), kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse.
- d) Për impiantin e asfaltit, duhet të paraqiten kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot ose fatura tatimore përkatëse, lejen mjedisore lëshuar nga QKL. Nëse është marrë me qira/furnizim, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit. Operatori ekonomik për fabrikën e asfaltit, mund të paraqesë edhe kontrata të vlefshme furnizimi me operatorë ekonomikë. Në këtë rast, duhet të paraqesë kontratën e furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton ekzistencën dhe pronësinë e impiantit, si dhe lejen mjedisore kodi III.1.B lëshuar nga QKL.
- e) Ndërsa për makineri dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur faturë zhdoganimi ose faturë tatimore blerje) dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- f) Për paisjet kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontratë blerje/faturë zhdoganimi/faturë tatimore blerje.
- g) Ndërsa për paisjet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur faturë zhdoganimi/faturë tatimore blerje) e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.
- h) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilën makineri dhe mjete dhe paisje të deklaruar.
- i) Për makineritë dhe mjetet, fotoja duhet të ketë të dallueshme edhe targën e mjetit.
- j) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fitues.

**Shënim:** Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese të ofertes, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, sjellim në vëmendje se:



- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit do t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjesve, mjeteve/pajisjeve do të jete kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis
- 
- Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorezuar perben kusht s'kualifikimi.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik"<sup>1</sup> në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burime të nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në nenin 39 "Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave" pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: "Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... **mjetet e pajisjet teknike**, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën."

- Nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t'u vendosur në DST. Vlerësohet se **operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë automjetet, mjetet dhe pajisjet e kërkuara me anë të cilave do të kryhet punimet (gërmime dheu dhe shkëmbi, prishje betoni, prerje asfalti, shtresa, shtrim asfalti, vendosje tubi, konstruksione etj.) dhe transporti i materialeve sipas zërave të punimeve të përcaktuara në preventivin e specifikimit teknike objekt kontrate**, ku sasia e tyre është kërkuar në përpjestim me natyrën e përmasat e këtyre punimeve, ku një operator ekonomik pa këto mjete e pajisje nuk mund t'i realizojë këto punimeve. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr.629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve të çmimeve të

punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

- Gjithashtu në zbatim të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”, **është kërkuar që operatorët ekonomikë duhet të disponojnë dhe pajisjet mbrojtëse për punonjësit të cilët do të angazhohen për kryerjen e punimeve objekt kontrate.**
- Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike.

Eshte vlerësuar si e domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatëse në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi, me qëllim verifikimin dhe kontrollimin se vërtet këto mjete dhe pajisje disponohen nga operatorët ekonomikë, ka kërkuar që këto të fundit të deklarojnë vendndodhjen e tyre. Cdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të tyre.

Makineritë kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton, kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 15 ton, Kamion me kapacitet mbajtës 5-7 ton dhe kamioncinat janë kërkuar për transportin e materialeve që do të dalin gjatë gërmimeve sipas kërkesave në preventiv, ku ka gërmime në volumet e mëdha në total si edhe transport dheu me auto në volume të konsiderueshme. Gjithashtu ky proces do të vazhdojë me sistemime, mbushje ngjeshje, drenazhime dhe transport të materialeve për shtresa rrugore, inerte, si dhe transportin e mbetjeve inerte të gjeneruara dhe depozitimin e tyre në landfill.

Mjetet Eskavator me goma për gërmim dheu 0,25m<sup>3</sup> është kërkuar sipas kërkesave të preventivit.

Makineritë betoniere të vogla, autopompë betoni, autobetoniere, vibrator betoni, armatura betoni, autobot uji, Armature sigurie për hapje kanali Palangola, pompë uji janë kërkuar duke patur parasysh punimet në beton të cilat janë të konsiderueshme në preventiv.

Është kërkuar pajisje Tokmak ngjeshes dheu e cila shërben gjatë procesit të gërmimeve që përfshin preventivi i punimeve në të cilin është parashikuar mbushje, rrafshim, ngjeshje me tokmak në disa zëra të tij.

Fadromë me goma është kërkuar duke patur parasysh specifikimet teknike të publikuara në SPE.

Elektro bango kerkohen për punimet të hekurit.

Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro Fusion” aparature e cila shërben për ngjijtjen e tubave.

Asfaltoshtruese, Autobitumatrice, Rrul asfalti gom gome mbi 18 (ton), sharr asfalti – kerkohen per punimet e asfaltobetonit te parashikuara ne preventiv.

Makineri për shpim horizontal për të zëvendësuar tubin ekzistues për kalimin e tubacioneve, Automjet teknologjik per pastrimin e pusetave te kolektoreve te KUZ dhe KUSH dhe pusetave te shiut e pajisur me bot me kapacitet bartes jo me pak se 4 ton, e pajisur me kove hidraulike per ngarkimin e materialeve te ngurta dhe vinc me kapacitet ngrites jo me pak se 0.3 ton, kerkohet per punime per tubacione dhe puseta, pastrim i linjes ekzistuese te lidhjes se shtepive dhe mbingritje kapake pusetash ekzistuese.

Automjet teknologjik per inspektimin e kolektoreve me diameter (100÷2000) mm e pajisur me dy ose me shume sisteme kamerash per gjatesi inspektimi jo me pak se 200 m, Motopompe per largimin e ujrave te ndotura me prurje deri ne 4000 litra/minut, dhe presion pune jo me te vogel se 8 bar, kerkohet per punimet e kolektoreve.

Eskavator me zinxhire, minieskavator me zinxhire, bobcatme goma, jane kerkuar per punimet e germimeve dhe dhe zhvendosjes se dheut, dhe zhvendosjes se inerteve, dhe mbetjeve inerte te gjeneruara nga punimet e ndryshme.

Rrul vibrues hekur hekur mbi 8 ton, Rrul gom hekur mbi 10 ton – kerkohet per shtrimin, ngjeshjen e shtresave inerte.

Makineri me lazer per germim kanali nentokesor mikrotunel d=140mm, kerkohet per intersektimet me rrjetin ekzistues.Kontenier per zyra, gjenerator, kerkohet per tu vendosur ne kantierin e objektit ku do te stacionohen inxhinieret dhe stafi teknik i cili do te kryej punimet ne terren.Eshte kerkuar impiantin e asfaltit, duhet të paraqiten kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot ose fatura tatimore përkatëse, lejen mjedisore lëshuar nga QKL. Nëse është marrë me qira/furnizim, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit. Operatori ekonomik për fabrikën e asfaltit, mund të paraqesë edhe kontrata të vlefshme furnizimi me operatorë ekonomikë. Në këtë rast, duhet të paraqesë kontratën e furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton ekzistencën dhe pronësinë e impiantit, si dhe lejen mjedisore kodi III.1.B lëshuar nga QKL

Eshte vleresuar se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë objekt prokurimi.

## **NJESIA E PROKURIMIT:**